




INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



GJENDJA ME SËMUNDJET E SISTEMIT
TË QARKULLIMIT TË GJAKUT NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

2016 - 2018

**ISHP Instituti i shëndetit publik i
Republikës së Maqedonisë së Veriut**

UD Drejtor: Doc. Dr. Shaban MEMETI

**QENDRA PËR PËRPUNIM STATISTIKOR TË TË DHËNAVE
SHËNDETËSORE, PUBLIKIM DHE EDUKIM**

Mr. Dr. Vjosa Reçica	Udhëheqëse e Qendrës
Dipl.ing. Armend Iseni	Zëvendës udhëheqës sektori
Prim. Dr. Dragana Çkaleska	Udhëheqëse departamenti
Prim. Dr. Vesna Stambolieva	Udhëheqëse e Sektorit për promovim dhe ndjekje të sëmundjeve joinfektive
Inf. dipl. Vesna Zafirovska	Teknik përgjegjës, Punonjës i pavarur i statistikës
Inf. dipl. Jovanka Trpkovska	Punonjës i pavarur i statistikës
Inf. dipl. Jasmina Tahiri	Punonjës i pavarur i statistikës
Inf. dipl. Nadezhda Lisinac	Punonjës i pavarur i statistikës
Stanisllava Najdovska	Punonjëse e statistikës
Marta Ziba Rashidi	Përkthyes
Borçe Andonovski	Administrues i sistemit
Suzana Dungevska	Dizenjatore grafike

**Bashkëpunëtorë:
Qendrat e shëndetit publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

HYRJE

Informacioni "Gjendja me sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2016-2018, është përgatitur në Institutin e Shëndetit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qendra për përpunimin statistikor të të dhënave shëndetësore, publikim dhe edukim, me rastin e Ditës botërore të zemrës.

Informacionet dhe të dhënat për vdekshmërisë dhe morbiditetin nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë përgatitur në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar Statistikor të Sëmundjeve dhe problemeve të ngjashme të shëndetit – revizioni i dhjetë (ICD-10).

Për përgatitjen e të dhënave për vdekshmërinë janë përdorur të dhënat për personat e vdekur nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në Maqedoninë e Veriut nga ana e Entit Shtetëror të Statistikës të përpunuara në bazë të parametrave të ndryshëm në Institutin e Shëndetit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Informacionet i përmbajnë shkallët e vdekshmërisë dhe struktura (përqindja) e vdekjeve sipas gjinisë. Të dhënat janë paraqitur në tabela dhe diagrame sipas rajoneve statistikore të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkallët e vdekshmërisë janë përlogaritur për 100,000 banorë.


Për përgatitjen të dhënave morbiditetin në spitale janë përdorur të dhënat individuale nga "Raportet për të sëmurët stacionarë" të grumbulluara nga spitalet nëpërmjet qendrave të shëndetit publik në vend, të përpunuara në fushat që mbulojnë dhe të dorëzuara në Institutin e Shëndetit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Informacioni përmban shkallët e morbiditetit dhe strukturës (përqindjes) së pacientëve të trajtuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në total trajtuar në objektet spitalore shëndetësore në popullatën e përgjithshme dhe sipas gjinisë. Shkallët e morbiditetit janë vlerësuar në 10.000 banorë.

Për morbiditetin nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në shërbimin ambullantor janë përdorur raporte përmbledhëse të të dhënave për sëmundjet e përcaktuara dhe kushtet e regjistruara në kujdesin ambulator- shëndetësor të ofruar nga shërbimet statistikore të Qendrave të shëndetit publik në Institutin e Shëndetit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Të dhënat janë grumbulluar nga e gjithë Republika e Maqedonisë së Veriut, sipas rajoneve statistikore për trajtim të përgjithshëm të sëmundjeve të sistemit të qarkullimit të gjakut në sektorin ambulator- dhe sidomos në disa sektorë (lëmia e mjekësisë së përgjithshme, kujdesi shëndetësor për fëmijët e moshave shkollore dhe të rinjve dhe kujdesi shëndetësor për fëmijët nga 0-6 vjeç). Struktura dhe shkallët e morbiditetit janë përlogaritur në 10.000 banorë përkatësisht janë paraqitur në tabela dhe diagrame.

Trendi i vdekshmërisë dhe morbiditetit nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në mesin e popullatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën e analizuar është paraqitur në pika indeksi dhe diagrame.

SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT

Morbiditeti ambullantor poliklinik



*Instituti i shëndetit publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut
Qendra për përpunim statistikor të të dhënave shëndetësore, publikim dhe edukim*


MORBIDITETI AMBULLANTOR POLIKLINIK NGA SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT, 2016-2018

Në veprimtarinë ambullantore poliklinike (mbrojtja shëndetësore primare) sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut zënë vendin e dytë në strukturën e morbiditetit (pas sëmundjeve të sistemit respirator). Në periudhën nga viti 2016-2018, përqindja e sëmundjeve sistemit të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të të mjekuarve në mbrojtjen shëndetësore primare ka rënë nga 14,4% në vitin 2016 në 14,1% në vitin 2018. Linja e trendit të pjesëmarrjes procentuale tregon për një tendencë të rënies së numrit (Tabela 1, Diagrami 1).

PJESËMARRJA PROCENTUALE E PACIENTËVE TË MJEKUAR NGA SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT NË NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PACIENTËVE TË MJEKUAR NË VEPRIMTARINË AMBULLANTORE POLIKLINIKE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, 2016-2018

Tabela 1

VITI	Numri i përgjithshëm i pacientëve të mjekuar	Pacientë të mjekuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	% nga numri i përgjithshëm
2016	5017483	721544	14,4
2017	4764637	678600	14,2
2018	5056142	714464	14,1
Indeksi 2018/2016	100,8	99,0	




Në periudhën e analizuar numri i përgjithshëm i pacientëve të trajtuar në mbrojtjen shëndetësore primare (veprimtaria e mjekësisë së përgjithshme, mbrojtja shëndetësore e fëmijëve të moshave shkollore dhe të rinjve dhe mbrojtja shëndetësore e fëmijëve nga 0-6 vjet) është rritur për 0,8%, ndërsa sa i përket të mjekuarve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut numri është zvogëluar për 1,0% (tabela 1).


Mesatarisht gjatë një viti në periudhën nga viti 2016-2018, nga numri i përgjithshëm i pacientëve të trajtuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut, 99,4% janë mjekuar në veprimtarinë e mjekësisë së përgjithshme (popullatë e rritur nga 20 e më shumë vjet), 0,5% në veprimtarinë për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve të moshave shkollore dhe të rinjve (7-19 vjet) dhe 0,1% në veprimtarinë për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve (0-6 vjet) (Tabela 2; Diagrami 2 dhe 3).

PJESËMARRJA PROCENTUALE E PACIENTËVE TË MJEKUAR NGA SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT NË VEPRIMTARINË AMBULLANTORE POLIKLINIKE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, 2016-2018

Tabela 2

VITI	Numri i përgjithshëm i pacientëve të mjekuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	%	Mjekësia e përgjithshme	% nga numri i përgjithshëm	Fëmijë të moshave shkollore dhe të rinj	% nga numri i përgjithshëm	Fëmijë nga 0-6 vjet	% nga numri i përgjithshëm
2016	721544	100	717628	99,5	3530	0,5	386	0,05
2017	678600	100	674101	99,3	4089	0,6	410	0,06
2018	714464	100	709839	99,4	3584	0,5	1041	0,15
Mesatarja për periudhën	704869		700523	99,4	3734	0,5	612	0,09





Morbiditeti ambullantor poliklinik në 10 000 banorë nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut është zvogëluar nga 3485,3‰ në vitin 2016 në 3444,0‰ në vitin 2018 në Maqedoninë e Veriut (Tabela 3).

MORBIDITETI NË 10 000 BANORË NGA SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT NË VEPRIMTARINË AMBULLANTORE POLIKLINIKE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, 2016-2018

Tabela 3


VITI	Numri i përgjithshëm i pacientëve të mjekuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut		Mjekësia e përgjithshme		MSH e fëmijëve të moshave shkollore dhe të rinjve		MSH e fëmijëve nga 0-6 vjet	
	Numri	Shkalla/10 000	Numri	Shkalla/10 000	Numri	Shkalla/10 000	Numri	Shkalla/10 000
2016	721544	3485,3	717628	4502,1	3530	112,4	386	23,9
2017	678600	3274,3	674101	4208,8	4089	132,4	410	25,3
2018	714464	3444,0	709839	4413,5	3584	117,2	1041	64,9

Në diagramin 3.1 është paraqitur tendencë lineare e morbiditetit në 10000 banorë nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut të diagnostikuar në veprimtarinë ambullantore poliklinike me tendencë të për një rritje të vazhdueshme në periudhën në vazhdim.

Linja e trendit në veprimtarinë e mjekësisë së përgjithshme tregon rritje, në veprimtarinë për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve të moshave shkollore dhe të rinjve tregon për një tendencë të zvogëlimit të numrit, ndërsa në veprimtarinë për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve nga 0-6 vjet vihet re një tendencë e rritjes të shkallës së morbiditetit nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut për periudhën nga viti 2013-2018 (Diagrami 3.2 dhe 3.3).


Morbiditeti nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në veprimtarinë ambullantore poliklinike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2013-2018

Diagrami 3.1




Morbiditeti në 10 000 banorë nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut i regjistruar në veprimtarinë e mjekësisë së përgjithshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2013-2018

Diagrami 3.2



Morbiditeti nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut i regjistruar në veprimtarinë për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve të moshave shkollore dhe të rinjve dhe fëmijëve nga 0-6 vjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2013-2018

Diagrami 3.3




**SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT TË REGJISTRUARA NË
VEPRIMTARINË E MJEKËSISË SË PËRGJITHSHME SIPAS RAJONEVE
STATISTIKORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2018**

Tabela 4

RAJONET STATISTIKORE	2018		
	Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut (I00-I99)	% nga numri i përgjithshëm	Shkalla/10 000
R. E MAQEDONISË SË VERIUT NUMRI I PËRGJITHSHËM	709839	19,1	4413,5
RAJONI I PELLAGONISË	69005	17,9	3787,7
RAJONI I VARDARIT	78893	18,4	6575,9
RAJONI VERILINDOR	48421	23,0	3596,9
RAJONI JUGPERËNDIMOR	67959	20,4	3928,9
RAJONI I SHKUPIT	248154	18,1	5224,7
RAJONI JUGLINDOR	49440	21,2	3650,3
RAJONI POLLOGUT	90171	19,9	3658,7
RAJONI LINDOR	57796	18,8	4077,6

Në strukturën sipas rajoneve statistikore, në vitin 2018 në veprimtarinë e mjekësisë së përgjithshme sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të pacientëve të mjekuar në këtë veprimtari kanë qenë më të përfaqësuara në Rajonin verilindor (23,0%), Rajonin juglindor (21,2%) dhe Rajonin jugperëndimor (20,4%). Shkallë më e lartë e morbiditetit në 10 000 banorë në vitin 2018 është regjistruar në Rajonin e Vardarit (6575,9‰) dhe Rajonin e Shkupit (5224,7‰) (Tabela 4, Diagrami 4;).





Morbiditeti ambullantor poliklinik nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut të regjistruara në veprimtarinë e mjekësisë së përgjithshme sipas rajoneve statistikore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në vitin 2018
Diagrami 4







Tendenca e morbiditetit nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në 10 000 banorë në veprimtarinë e mjekësisë së përgjithshme sipas rajoneve statistikore për periudhën nga viti 2016-2018 është prezantuar në diagramin 4.1.

TENDENCA E MORBIDITETIT NGA SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT NË VEPRIMTARINË E MJEKËSISË SË PËRGJITHSHME SIPAS RAJONEVE STATISTIKORE, NË PERIUdhËN NGA VITI 2016-2018


Diagrami 4.1





SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT

Morbiditeti spitalor



*Instituti i shëndetit publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut
Qendra për përpunim statistikor të të dhënave shëndetësore, publikim dhe edukim*

MORBIDITETI SPITALOR NGA SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT


Në veprimtarinë spitalore numri i pacientëve të mjekuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut shënon rritje. Në vitin 2016 numri i pacientëve të mjekuar në spital nga këto sëmundje ka qenë 33713 ose 13,1% nga numri i përgjithshëm i pacientëve të mjekuar në veprimtarinë spitalore është rritur për 8,1% në vitin 2018 (36438 ose 13,5% nga numri i përgjithshëm i pacientëve të mjekuar në veprimtarinë spitalore)(Tabela 1).

PJESËMARRJA PROCENTUALE E PACIENTËVE TË MJEKUAR NGA SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT NË NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PACIENTËVE TË MJEKUAR NË VEPRIMTARINË SPITALORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, 2016-2018

Tabela 1


VITI	Numri i përgjithshëm i pacientëve të mjekuar	Pacientë të mjekuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	Shkalla/ 10 000	% nga numri i përgjithshëm
2016	257265	33713	162,8	13,1
2017	262099	38056	183,6	14,5
2018	269469	36438	175,6	13,5
Indeksi 2018/2016	104,7	108,1		

Shkalla e morbiditetit spitalor nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në 10 000 banorë është rritur nga 162,8‰ në vitin 2016 në 175,6‰ në vitin 2018. Linja e tendencës të shkallëve të morbiditetit në popullatën e përgjithshme për periudhën nga viti 2014-2018 tregon për një tendencë të rritjes së numrit (Diagrami 1).



Pjesëmarrja procentuale e pacientëve të mjekuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të të mjekuarve në veprimtarinë spitalore në RMV, 2018

Diagrami 2



СТРУКТУРА НА ПАЦИЕНТИ ТË МЈЕКУАР НГА СËМУНДЖЕТ Е СИСТЕМИТ ТË QARKULLIMIT TË GJAKUT NË VEPRIMTARINË SPITALORE STACIONARE SIPAS GJINISË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, 2016-2018

Tabela 2


VITI	MESHKUJ		FEMRA	
	Numri	%	Numri	%
2016	18599	55,2	15114	44,8
2017	21333	56,1	16723	43,9
2018	20984	57,6	15454	42,4

Në strukturën sipas gjinisë, numri i meshkujve të mjekuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut tregon një tendencë të rritjes për 12,8% ndërsa tek femrat numri i të mjekuarve është rritur për 2,2% për periudhën nga viti 2016-2018.

Meshkujt trajtohen më shpesh se femrat nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në veprimtarinë spitalore stacionare (57,6% meshkuj, 42,4% femra në vitin 2018). Gjatë periudhës së analizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përqindja e meshkujve ka shënuar rritje në krahasim me femrat e mjekuara në numrin e përgjithshëm të mjekuarve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut (Tabelat 2 dhe 3, Diagrami 3).

Struktura e pacientëve të mjekuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në veprimtarinë spitalore sipas gjinisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2018

Diagrami 3




MORBIDITETI NË 10 000 BANORË NGA SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT NË VEPRIMTARINË SPITALORE STACIONARE SIPAS GJINISË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, 2012-2018

Tabela 3


VITI	MESHKUJ		FEMRA	
	Numri	Shkalla/10 000	Numri	Shkalla/10 000
2012	18567	180,0	14516	141,3
2013	18437	178,6	14236	138,4
2014	18408	177,7	14162	137,3
2015	18404	177,7	14549	141,0
2016	18599	179,3	15114	146,3
2017	21333	205,5	16723	161,7
2018	20984	202,0	15454	149,2
Indeksi 2018/2012	113,02		106,46	

Gjatë periudhës nga viti 2012-2018 numri i meshkujve të mjekuar në spital nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut është rritur për

13,0% ndërsa numri i femrave të mjekuara në spital është rritur për 6,5% për periudhën e njëjtë (Tabela 3).



Linjat e tendencës tek pacientët e mjekuar në spital nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut gjatë periudhës nga viti 2013-2018 tregojnë për një tendencë të rritjes tek të dy gjinitë (Diagrami 4 dhe 4.1).



**SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT TË REGJISTRUARA NË
VEPRIMTARINË SPITALORE STACIONARE SIPAS RAJONEVE STATISTIKORE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2018**


Tabela 5

RAJONET STATISTIKORE	2018			Indeksi 2018/2016
	Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut (I00-I99)	% nga numri i përgjithshëm	Shkalla /10 000	
R. E MAQEDONISË SË VERIUT NUMRI I PËRGJITHSHËM	36438	13,5	175,6	108,1
RAJONI I PELLAGONISË	2899	8,0	126,3	86,7
RAJONI I VARDARIT	1204	10,8	79,0	80,6
RAJONI VERILINDOR	732	7,6	41,5	113,5
RAJONI JUGPERËNDIMOR	7617	16,1	346,7	140,1
RAJONI I SHKUPIT	17980	14,6	287,2	113,4
RAJONI JUGLINDOR	1348	12,5	77,7	93,7
RAJONI POLLOGUT	2500	14,4	77,8	69,6
RAJONI LINDOR	2158	15,7	122,7	113,8

Në shpërndarjen sipas rajoneve statistikore në vitin 2018 sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të pacientëve të hospitalizuar kanë qenë më të përfaqësuara në Rajonin jugperëndimor (16,1%). Në Rajonin verilindor janë mjekuar më pak të sëmurë nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut me 7,6% përfaqësim në numrin e përgjithshëm të të mjekuarve në veprimtarinë spitalore (Tabela 5).

Analiza e pacientëve të mjekuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në veprimtarinë spitalore stacionare në periudhën nga viti 2016-2018 flet për një rritje të numrit në 4 rajonet statistikore: atë Lindorin për

13,8%, Verilindorin (13,5%), të Shkupit (13,4%) dhe Jugperëndimorin (40,1%). Në rajonet e tjera vihet re një rënie e numrit.











Shkallë më e lartë e morbiditetit në 10 000 banorë në vitin 2018 është regjistruar në Rajonin jugperëndimor (346,7‰) dhe Rajonin e Shkupit (287,2‰), ndërsa më e ulët në Rajonin verilindor (41,5 numri i pacientëve të mjekuar në 10 000 banorë) (Tabela 5, Diagrami 5;).

Tendenca e morbiditetit nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në 10 000 banorë në veprimtarinë spitalore stacionare sipas rajoneve statistikore për periudhën nga viti 2016-2018 është prezantuar në diagramin 5.1.

TENDENCA E MORBIDITETIT OJ SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT NË VEPRIMTARINË SPITALORE STACIONARE SIPAS RAJONEVE STATISTIKORE, NË PERIUdhËN NGA VITI 2016-2018


Diagrami 5.1





SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT

Mortaliteti



MORTALITETI NGA SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, 2016-2018

Në strukturën e shkaqeve më të shpeshta të vdekjes sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut zënë vendin e parë dhe janë në një rritje të vazhdueshme tek popullata në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Tabela 1).

MORTALITETI NË 100.000 BANORË SIPAS SHKAQEVE MË TË SHPESHTA TË VDEKJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2018

Tabela 1

GRUPI I SËMUNDJEVE (SUBTOTALEVE) SIPAS KNS-10	NUMRI	%	Shkalla/ 10 000	RANGU
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT	19727	950,1	100	-
Neoplazmat (C00-D48)	3734	179,8	18,9	II
Sëmundjet endokrine, nutritive dhe metabolike (E00-E90)	927	44,6	4,7	III
Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut (I00-I99)	10632	512,1	53,9	I
Sëmundjet e sistemit respirator (J00-J99)	802	38,6	4,1	IV
Sëmundjet e sistemit digjestiv (K00-K93)	375	18,1	1,9	VII
Sëmundjet e sistemit urogjenital (N00-N99)	323	15,6	1,6	VIII
Gjendje të caktuara që ndodhin në periudhën perinatale (P00-P99)	84	4,0	0,4	
Simptoma, shenja dhe diagnoza të paklasifikuara në vend tjetër (R00-R99)	1772	85,3	9,0	
Lëndime dhe helmime (S00-T98)	477	23,0	2,4	
Të tjera	601	28,9	3,0	

Në periudhën nga viti 2016-2018, përqindja e të vdekurve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të të vdekurve është rritur nga 53,5% në vitin 2016 në 53,9% në vitin 2018. (Tabela 2, Diagrami 1, 2 dhe 3).


PËRQINDJA E TË VDEKURVE NGA SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT NË NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË TË VDEKURVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, 2016-2018

Tabela 2

VITI	Numri i përgjithshëm i të sëmurëve	Numri i të vdekurve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	% nga numri i përgjithshëm i të vdekurve
2016	20421	10920	53,5
2017	20318	11172	55,0
2018	19727	10632	53,9
Indeksi 2018/2016	96,6	97,4	


Pjesëmarrja procentuale e të vdekurve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të të vdekurve në RMV, 2012-2018

Diagrami 1




Pjesëmarrja procentuale e të vdekurve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të të vdekurve në RMV, 2016


Diagrami 3



Pjesëmarrja procentuale e të vdekurve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të të vdekurve në RMV, 2018
Diagrami 3



Persona të vdekur nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në RMV, 2012-2018
Diagrami 4




Numri i përgjithshëm i të vdekurve në Republikën e Maqedonisë së Veriut është zvogëluar për 3,4%, ndërsa numri i të vdekurve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut si shkak kryesor i vdekjes është zvogëluar për 2,6% në periudhën nga viti 2015-2017. Linja e tendencës për periudhën nga viti 2012-2018 tregon për një tendencë të zvogëlimit të numrit në periudhën e ardhshme (Diagrami 4).

Shkalla e mortalitetit në 100000 banorë nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë së Veriut është zvogëluar nga 526,9‰ në vitin 2016 në 512,1‰ në vitin 2018 (Tabela 3, Diagrami 5).

MORTALITETI NË 100000 BANORË NGA SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, 2016-2018

Tabela 3

VITI	Numri i përgjithshëm i të vdekurve	Numri i përgjithshëm i të vdekurve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	Shkalla/ 10 000
2016	20421	10920	526,9
2017	20318	11172	538,5
2018	19727	10632	512,1
Indeksi 2018/2016	96,6	97,4	



Në shpërndarjen e të vdekurve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut sipas rajoneve statistikore në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2018, shkallë më e lartë të mortalitetit në 100000 banorë është vërtetuar në Rajonin juglindor (654,1‰), Rajonin e Vardarit (610,0‰), Rajonin lindor (602,6‰), Rajonin e Pellagonisë (558,6‰) etj. Nga mesatarja republikane (512,1 të vdekur nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në 100000 banorë) përjashtim bëjnë 6 rajone me shkallë më të larta të mortalitetit. Rajoni i Pollogut dhe Rajoni i Shkupit kanë shkallë më të ulëta të mortalitetit nga këto sëmundje (Tabela 4, Diagrami 6).

NUMRI I TË VDEKURVE NGA SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT SIPAS RAJONEVE STATISTIKORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2018

Tabela 4

RAJONET STATISTIKORE	2018			Indeksi 2018/2016
	Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut (100-199)	% nga numri i përgjithshëm i të vdekurve	Shkalla/10 0000	
R. E MAQEDONISË SË VERIUT NUMRI I PËRGJITHSHËM	10632	53,9	512,1	97,4
RAJONI I PELLAGONISË	1276	43,8	558,6	92,9
RAJONI I VARDARIT	928	58,0	610,0	90,1
RAJONI VERILINDOR	935	57,6	530,6	105,1
RAJONI JUGPERËNDIMOR	1246	64,8	567,3	96,3
RAJONI I SHKUPIT	2671	47,4	424,5	93,8
RAJONI JUGLINDOR	1134	64,6	654,1	107,6
RAJONI POLLOGUT	1386	58,6	430,5	102,4
RAJONI LINDOR	1056	55,1	602,6	98,1


BURIMI: Enti shtetëror i statistikës

PËRPUNOI: Instituti i shëndetit publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Qendra për përpunim statistikor të të dhënave shëndetësore, publikim dhe edukim

Mortaliteti nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut sipas rajoneve statistikore në RMV në vitin 2018

Diagrami 6







Në strukturën e të vdekurve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të të vdekurve në vitin 2018, në 6 rajonet statistikore zënë 53,9% ndërsa vetëm në 2 rajone statistikore, Rajonin e Pellagonisë dhe Rajonin e Shkupit nuk tejkalohet mesatarja republikane (Tabela 4).





Analiza e të vdekurve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut si shkak kryesor i vdekjes në vitin 2018 krahasuar me vitin 2016 viti tregon për një rënie të numrit të të vdekurve në 5 rajone statistikore, ndërsa rritje në 3 rajone statistikore, Juglindor, të Pollogut dhe atë Verilindor.

Lëvizja e mortalitetit nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në 100000 banorë sipas rajoneve statistikore për periudhën nga viti 2016-2018 është prezantuar në diagramin 6.1.

TENDENCAT E LËVIZJES SË MORTALITETIT NGA SËMUNDJET E SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT SIPAS RAJONEVE STATISTIKORE, NË PERIUdhËN NGA VITI 2016-2018

Diagrami 6.1





PËRFUNDIME:

- Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut zënë vendin e parë të mortalitetit si shkak kryesor i vdekjes dhe vendin e dytë sipas morbiditetit menjëherë pas sëmundjeve të sistemit të frymëmarrjes në popullatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Përqindja e sëmundjeve të sistemit të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të të mjekuarve në mbrojtjen shëndetësore primare arrin 14,1%.
- Në periudhën e analizuar numri i përgjithshëm i pacientëve të trajtuar në mbrojtjen shëndetësore primare (veprimtaria e mjekësisë së përgjithshme, mbrojtja shëndetësore e fëmijëve të moshave shkollore dhe të rinjve dhe mbrojtja shëndetësore e fëmijëve nga 0-6 vjet) është rritur për 0,8%, ndërsa numri i pacientëve të mjekuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut është zvogëluar për 1,0%.
- **Morbiditeti ambullantor poliklinik** në 10 000 banorë nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut është zvogëluar nga 3485,3‰ në vitin 2016 në 3444,0‰ në vitin 2018 në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- **Trendi linear** për periudhën nga viti 2013-2018 i morbiditetit në 10 000 banorë nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut të diagnostikuara në veprimtarinë ambullantore poliklinike është me një tendencë të rritjes së vazhdueshme në periudhën në vazhdim.
- Në strukturën sipas rajoneve statistikore, në vitin 2018 në veprimtarinë e mjekësisë së përgjithshme sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të pacientëve të mjekuar në këtë veprimtari kanë qenë më të përfaqësuara në Rajonin verilindor (23,0%), Rajonin juglindor (21,2%) dhe Rajonin jugperëndimor (20,4%). **Shkallë më e lartë e morbiditetit** në 10 000 banorë në vitin 2018 është regjistruar në Rajonin e Vardarit (6575,9‰) dhe Rajonin e Shkupit (5224,7‰).
- Në veprimtarinë spitalore numri i pacientëve të mjekuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut rritet vazhdimisht. Në vitin 2016 numri i pacientëve të mjekuar në spital nga këto sëmundje ka qenë 33713 ose 13,1% nga numri i përgjithshëm i pacientëve të mjekuar në veprimtarinë spitalore është rritur për 8,1% në vitin 2018 (36438 ose 13,5% nga numri i përgjithshëm i pacientëve të mjekuar në veprimtarinë spitalore).
- **Meshkujt më shpesh se femrat mjekohen** nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në veprimtarinë spitalore stacionare (57,6% meshkuj, 42,4% femra në vitin 2018).

- Në strukturën sipas gjinisë, numri i meshkujve të trajtuar në spital nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut tregon një tendencë të rritjes për 13,0% ndërsa tek femrat numri është rritur për 6,5% për periudhën nga viti 2016-2018.
- Në shpërndarjen sipas rajoneve statistikore në vitin 2018 sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të pacientëve të hospitalizuar kanë qenë më të përfaqësuara në Rajonin jugperëndimor (16,1%). Në Rajonin verilindor ka më pak të mjekuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut me 7,6% përfaqësim në numrin e përgjithshëm të të mjekuarve në veprimtarinë spitalore.
- Analiza e pacientëve të mjekuar nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në veprimtarinë spitalore stacionare në periudhën nga viti 2016-2018 tregon një rritje të numrit në 4 rajonet statistikore: Në Rajonin lindor 13,8%, në atë Verilindor (13,5%), në Rajonin e Shkupit (13,4%) dhe atë Jugperëndimor (40,1%) Në rajonet e tjera ka rënie të numrit.
- Në strukturën e shkaqeve më të shpeshta të vdekjes sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut zënë vendin e parë dhe numri i personave që vuajnë nga këto sëmundje në Republikën e Maqedonisë së Veriut po rritet vazhdimisht.
- Në periudhën nga viti 2016-2018, përqindja e të vdekurve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të të vdekurve është rritur nga 53,5% në vitin 2016 në 53,9% në vitin 2018.
- Numri i përgjithshëm i personave të vdekur në Republikën e Maqedonisë së Veriut është zvogëluar për 3,4%, ndërsa numri i të vdekurve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut si shkak kryesor i vdekjes është zvogëluar për 2,6% në periudhën nga viti 2016-2018.
- Shkalla e mortalitetit në 100000 banorë nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë së Veriut është zvogëluar nga 526,9%000 në vitin 2016 në 512,1%000 në vitin 2018.
- Sa i përket shpërndarjes të të vdekurve nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut sipas rajoneve statistikore në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2018, shkallë më të lartë të mortalitetit në 100000 banorë është vërtetuar në Rajonin juglindor (654,1%000), Rajonin e Vardarit (610,0%000), Rajonin lindor (602,6%000) Rajonin e Pellagonisë (558,6%000). Nga mesatarja republikane (512,1 të vdekur nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në 100000 banorë) përjashtim bëjnë 6 rajone

me shkallë më të larta të mortalitetit. Në Rajonin e Pollogut Rajonin e Shkupit ka shkallë më të ulët të mortalitetit nga këto sëmundje.

- Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut janë një problem shëndetësor prioritar në patologjinë e popullatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Për çrrënjosjen dhe parandalimin e shfaqjes të këtyre sëmundjeve me rëndësi është të ndërmerren masa preventive efikase për eliminimin e faktorëve të rrezikut: pirja e duhanit, alkooli, mbipesha, mungesa e aktivitetit fizik, konsumi i vogël i frutave dhe perimeve, konsumi i tepruar i sheqernave, stresi, faktorët psiko-social, ndotja e ajrit, etj.